

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-111/13

Prishtinë, 12 mars 2014

Në çështjen juridike të:

H K , i përfaqësuar nga Kimete Kameraj
M G 28
M

Palë ankuese

Kundër

Palës përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetari i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/2013 të datës 14 dhjetor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 1026), pas shqyrtimit të mbajtur më 12 mars 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa.**
- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/2012, i datës 14 dhjetor 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar ne numrin KPA 1026.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale:

1. Me 20 korrik 2007 pala ankuese ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit ndaj një banese në bllokun banesor në rrugën Obiliviceva nr. 28 në Mitrovicës (banesa).
2. KKPK-ja kishte vendosur që të hedhë poshtë kërkesën, sepse humbja e së drejtës së shfrytëzimit ndaj banesës nuk ishte pasojë e rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999.
3. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 23 prill 2013.
4. Pala ankuese ka paraqitur ankesë në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 7 maj 2013, që është brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe atë Komerciale.

Përmbledhja e çështjeve faktike

Kolegji i Apelit konkludon se vendimi i KKPK-ës është i bazuar në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjë që edhe palët në kontest nuk e kundërshtojnë

5. Pala ankuese e kishte marrë në shfrytëzim banesën që nga nëntori i vitit 1987. Palës ankuese i ishte dhënë e drejta e shfrytëzimit më 10 nëntor 1987 me vendimin e Komitetit Komunal për Urbanizëm Strehim dhe Çështje Komunale të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Titos.
6. Në vitin 1992, pala ankuese ishte akuzuar për zbulim të sekretit shtetëror dhe ishte arrestuar. Pala ankuese ishte përjashtuar nga puna dhe i ishte hequr e drejta e shfrytëzimit. Pas lirimimit nga

arresti, ai kishte emigruar. Po kështu bënë edhe bashkëshortja dhe fëmijët e tij më vonë po atë vit.

7. Këto ngjarje kanë ndodhur nën regjimin e Millosheviqit.
8. Pala ankuese kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit ndaj banesës pasi që banesa është marrë në posedim dhe shfrytëzimi nga palë të treta.

Arsyetim ligjor:

Pretendimi i palës ankuese

9. Pala ankuese kërkon ndryshimin e vendimit të KKPK-së në atë mënyrë që atij t'i njihet e drejta e shfrytëzimit.

Juridiksioni

10. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
11. Pasi që pala ankuese e ka humbur mundësinë e ushtrimit të së drejtës së shfrytëzimit në vitin 1992, rreth gjashtë vite para konfliktit të armatosur të lartpërmendur, KKPK-ja më të drejtë ka vendosur që të mos ketë juridiksion mbi këtë çështje dhe që të hedhë poshtë kërkesën e palës ankuese.
12. Pala ankuese sugjeron se humbja e mundësisë për ushtrimin e së drejtës së shfrytëzimit ishte rezultat i aktiviteteve politike në vitin 1992. Megjithatë, kjo nuk bënë që kjo ngjarje të bie në fushëveprim të Rregullores. Teksti i nenit 3.1 të Rregullores është i qartë për sa i përket kufizimit të juridiksionit në periudhën e përmendur.

Konkludim

13. Çështje e lartpërmendur bëjnë Gjykatën Supreme që të nxjerrë konkludim se kërkesa e palës ankuese duhet të hedhet refuzohet.

Udhëzim juridik

14. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it